



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	23.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefit Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshe e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Cilësia e planit të biznesit dhe nxitja për përmirësim

Të nderuar,

Konsultimi publik i janarit 2024 theksoi cilësinë e dobët të planeve të biznesit të paraqitura nga KRU-të në proceset tre-vjeçare të shqyrtimit të tarifave deri tani. Si rezultat i konsultimit, është propozuar miratimi i një mekanizimi nxitës, që është aplikuar me sukses në sektorët e energjisë dhe ujit në Mbretërinë e Bashkuar. Kur ARRU konsideron një plan të paraqitur si të një cilësie të lartë, përsa i përket mbështetjes në evidencë të fortë, dizajni i përgatitur, i kompletuar dhe në shërbim të konsumatorëve përmes projeksioneve sfiduese dhe realiste për përmirësim të efijencës dhe shpenzimeve do të duhej të kategorizohej si "vlerësim i përsheptuar".

Në dokumentin konsultues me publikun ARRU ka konsideruar opsionin e ofrimit të stimulimeve financiare përmes rritjes së koeficientit të kthimit në kapital BRRR për KRU-të për të hartuar plane të biznesit që plotësojnë pritshmëritë e ARRU për tu kualifikuar si "vlerësim i përsheptuar". Pas shqyrtimeve më të thella ARRU ka vendosur që për procesin e shqyrtimit tarifor 2026-2028 të mos aplikojë stimujt financiar. ARRU konsideron se stimujt e tillë mund të aplikohen vetëm pasi të jemi të bindur se KRU-të janë në gjendje të hartojnë plane që i plotësojnë kriteret e vendosura. Rrjedhimisht, nëse KRU-të mund të demonstrojnë aftësi për të përgatitur plane dukshëm më të përmirësuara gjatë ciklit të shqyrtimit tarifor 2026-2028 ARRU mund të konsiderojë aplikimin e stimujve për shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Planet e biznesit që ne i konsiderojmë se i plotësojnë kriteret e "vlerësimit të përsheptuar" siç përcaktohet në këtë shkresë do ti nënshtrohen një niveli shumë më të vogël të shqyrtimit/ vlerësimit rregullator gjatë procesit të rishikimit të tarifave dhe mund të presin përcaktimet tona shumë më herët se ato që nuk kualifikohen si "vlerësim i përsheptuar".

Aspekti kyç që do të shqyrtohet në përcaktimin tonë, nëse një plan përmbush pragun e 'vlerësimit të përsheptuar' është EVIDENCA. Elementët e planit që nuk mbështeten në evidenca do të llogariten si të pa kualifikuar dhe madje mund të refuzohen nga plani, veçanërisht propozimet e investimeve që nuk mbështeten në evidenca të forta.

Ne këshillojmë, që për t'u kualifikuar si "vlerësim i përsheptuar", KRU-të duhet të fillojnë menjëherë me planifikimin e tyre për periudhën e 'Procesit Tarifor 2026-2028' dhe, nëse besojnë se investimi në ekspertizën

e jashtme do t'i ndihmojë ato për ta arritur këtë, ato nuk duhet të humbasin kohë në prokurimin e shërbimeve të tilla. ARRU nuk do të kiste kundërshtime, nëse dy ose më shumë KRU bashkojnë burimet e tyre për të përfituar nga ekonomitë e shkallës për të siguruar ekspertizë më të mirë të cilësisë që mund t'u shërbejë më shumë KRU-ve në zhvillimin e planeve të tyre.

Shtojca A – Kriteret për planet e biznesit që përmbushin statusin e “vlerësim i shpejtë”.

Ne do të shqyrtojmë planet e biznesit që do të paraqiten për të mbështetur ‘shqyrtimin tarifor 2026-2028’ për të përcaktuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre. Ato që konsiderohen me cilësi të lartë do të konsiderohen si “vlerësim i shpejtë” dhe si të tillë nuk do t’i nënshtrohen të njëjtit nivel kontrolli si paraqitjet ‘me rrugë të ngadaltë’. KRU-të që paraqesin plane biznesi që kualifikohen si ‘fast-track’ do të shpërblehen me një kthim më të lartë në BRRRA sesa ato që nuk e plotësojnë këtë kriter. Kthimi shtesë në BRRRA do të jetë deri në 0.25% për KRU “Prishtina” dhe deri në 0.40% për gjashtë KRU-të e mbetura.

Ne do të vlerësojmë planet mbi disa kritere:

1. Harmonizimi i planit rregullator të biznesit me planin e biznesit i dorëzuar tek Qeveria.
2. Plani i menaxhimit të aseteve i inkorporuar në planin e biznesit është realist me gjasa të larta për t’u realizuar plotësisht.
3. Plani operacional është realist me gjasa të larta për t’u realizuar plotësisht.
4. Plani komercial është realist me gjasa të larta për t’u realizuar plotësisht.
5. Plani financiar është realist, përfshinë përmirësimet e pritshme të efektshmërisë dhe ka një rrjedhë pozitive neto të parave të gatshme.
6. Objektivat për përmirësimin e nivelit të shërbimit janë përqëndruar në përfitimet e konsumatorëve dhe se objektivat kanë gjasa të larta për t’u përmbushur.
7. Plani konsideron ndikimin e veprimtarive të KRU në mjedis dhe merr masa për të pakësuar çdo ndikim të dëmshëm.

Në të gjitha rastet vlerësimi ynë i planeve të biznesit do të jetë i bazuar në prova. Ne presim të shohim prova të mjaftueshme për t’u bindur se veprimtaritë, objektivat dhe shpenzimet siç janë përcaktuar në planet e biznesit janë të justifikueshme, realiste dhe ka të ngjarë të realizohen. Propozimet për investime dhe veprimtari të tjera që nuk mbështeten nga prova të forta mund të shpërfillen në përcaktimet tona përfundimtare tarifore.

Seksionet e mëposhtme i përshkruajnë këto kritere më hollësisht.

Harmonizimi i planit rregullator të biznesit, me planin e biznesit, siç i është dorëzuar Qeverisë

Në shumë raste, paraqitjet e planeve të biznesit të KRU-ve për proceset tarifore kanë devijuar nga planet që i kanë dorëzuar qeverisë. Nuk shohim asnjë arsye pse këto dallime duhet të ekzistojnë. Si pjesë e shqyrtimit tonë, ne do t’u kërkojmë KRU-ve të përdorin planet e tyre më të fundit që i kanë paraqitur Qeverisë, si bazë për aplikacionet tarifore dhe ne do të krahasojmë përputhjen e planeve . *Planet që demonstrojnë një shkallë të lartë të harmonizimit do të konsiderohen si përmbushje e këtij kriteri.* Për ato plane që nuk janë të harmonizuara, ne do të marrim në shqyrtimin tarifor ato vlera që do të rezultojnë tarifën më të ulët, p.sh. nëse plani i biznesit për përcaktimin e tarifave përfshin 1 milion euro për mirëmbajtjen kapitale të infrastrukturës, por plani i paraqitur në Qeveri përfshin vetëm 0.6 milionë euro, ne do të shqyrtojmë vlerën më të ulët për procesin e përcaktimit të tarifave.

Planet e menaxhimit të aseteve

Kjo është fusha jonë kryesore e shqetësimit. Konsultimi ynë theksoi mos realizimin e vazhdueshëm të investimeve kapitale në raport me ato të aprovuara me proces tarifor. Për vlerësimin tonë të ardhshëm të investimeve kapitale, ne do të kërkojmë prova të forta për të mbështetur veprimtaritë e investimit, duke përfshirë domosdoshmërinë e tyre për të përmbushur nivelet e kërkuara të shërbimit, kostot e tyre të vlerësuara dhe aftësinë për të realizuar investimet në përputhje me planin e paraqitur të investimeve. Për të gjitha investimet, ne kërkojmë prova për të mbështetur nevojën për investimin. Kjo mund të marrë formën e një raporti të projektimit, dëshmi nga një sistem raportimi GIS që mund të demonstrojë se një pasuri e veçantë ka nevojë për një riparim ose zëvendësim të madh, ose dëshmi të dështimit të nivelit të shërbimit në një fushë të caktuar dhe investimit të nevojshëm për të ndrequr dështimin. Një shkallë e lejimit të

kontigjencave për kërkesat e papritura të investimeve mund të jetë e pranueshme, por për pothuajse të gjitha veprimtaritë e investimit, ne kërkojmë prova për të justifikuar shpenzimet. Një shqyrtim nga një vlerësues i pavarur lidhur me domosdoshmërinë e investimeve do të rriste ndjeshëm cilësinë e provave.

Ne do të kërkojmë gjithashtu prova për të mbështetur kostot e projektuara të investimeve. Modeli ynë i përcaktimit të tarifave i konsideron investimet në vitin e finalizimit. Rrjedhimisht, shumica e investimeve që do të finalizohen në vitin 2026 me shumë gjasa do të jenë në ndërtim gjatë vitit 2025 kur janë duke u përgatitur paraqitjet e planit të biznesit tarifor dhe kostot janë të njohura, pra vlera e kontratës.

Investimet që pritet të finalizohen në vitin 2027 mund të jenë ose në ndërtim e sipër në vitin 2025 ose procesi i prokurimit do të jetë i avancuar mirë. Për këto investime, kostot e vlerësuara mund të nxirren nga vlerat e tenderit të kontratës, vlerësimet e inxhinierëve në dokumentet përfundimtare të projektimit dhe të dhënat nga projekte të ngjashme të kohëve të fundit. Mund të sigurohet njëfarë kontinuiteti, por presim që shkalla e pasigurisë të jetë e vogël.

Për investimet që pritet të finalizohen në vitin 2028, ne ende do të prisim që procesi i prokurimit të avancohet në mënyrë të arsyeshme me të paktën dizajnet paraprake dhe vlerësimet e kostos në dispozicion.

Ne gjithashtu duhet të jemi të bindur në lidhje me shkallën e sigurisë se veprimtaria e investimit do të vazhdojë sipas planifikimit. Provat për të mbështetur këtë mund të përfshijnë dëshmi të ndërtimit në vazhdim ose tenderave të marrë/lëshuar. Prova të tjera mund të përfshijnë angazhimet buxhetore të KRU dhe marrëveshjet e huave. Nëse nuk kemi prova mbështetëse të arsyeshme për të na bindur se investimet do të vazhdojnë sipas planifikimit, ne mund të zgjedhim të shpërfillim investime të tilla në procesin e përcaktimit të tarifave.

Planet operative

Ne do të shqyrtojmë kostot operacionale në vlerat e tyre të vitit bazë (2025) dhe modeli i përcaktimit të tarifave lejohet automatikisht që këto të rregullohen për inflacionin.

Vlerësimi ynë i planeve operacionale do të shqyrtojë veprimtaritë e planifikuara operacionale dhe kostot e tyre të efektshme. Edhe pse, mund të konsiderojmë se, shpenzimet operative të kaluara do të përdoren si bazë, ne presim që planet operacionale të përfshijnë përmirësimin e efektshmërisë operacionale në të gjitha fushat e veprimtarive të KRU-ve. Në një gjendje të qëndrueshme pa ndryshime materiale në veprimtaritë e KRU-ve kjo duhet të rezultojë në një reduktim real (të përshtatur për inflacionin) të kostove operative gjatë periudhës së shqyrtimit. Ne do të kërkojmë prova për të mbështetur nismat e efektshmërisë që përcaktojnë se si do të arrihen ato dhe nivelin e pritur të përmirësimeve. Përmirësimet e efektshmërisë nuk duhet të vijnë në koston e rënies së nivelit të shërbimit. Një plan operacional që nuk jep nivele materiale të përmirësimit të efikasitetit nuk do të konsiderohet si përmbushje e kriterit "vlerësim i shpejtë".

Në disa raste, mund të ketë justifikim për rritjen e kostove operacionale. Kjo mund të përfshijë struktura të tjera të tilla si një strukturë e trajtimit të ujit apo ujërave të zeza që pritet të funksionalizohen, duke shtuar kostot e përgjithshme operacionale. Një zgjerim i bazës së klientëve do të rrisë gjithashtu kostot por do të rezultojë gjithashtu në të ardhura shtesë, efekti neto i të cilave mund të jetë tarifata më të ulta. Arsye të tjera mund të përfshijnë kosto shtesë për veprimtaritë që nuk janë ndërmarrë më parë në të njëjtin nivel, p.sh. një ekip i zbulimit të humbjeve të ujit ose struktura të përmirësuar të shërbimeve të konsumit. Ne do të shqyrtojmë kosto të tilla shtesë me kusht që të ketë prova për të konfirmuar se ato janë të justifikueshme, realiste dhe do të realizohen.

Plani komercial

Planet e biznesit për aplikim tarifor, parashikojnë projeksione komerciale në aspekte të tilla si konsumatorët e rinj, faturimi, performanca e mbledhjes së të ardhurave dhe shërbimet e konsumatorëve. Ashtu si me planin operacional, ne, presim të shohim përmirësim të vazhdueshëm të mbështetur nga provat.

Në lidhje me parashikimet e lidhjeve të reja, ne kërkojmë të shohim prova të pritjeve nëpërmjet referencave ndaj planeve të zhvillimit të pushtetit lokal dhe burimeve të tjera përkatëse.

Me një normë të matjes së ujit prej gati 100%, projeksionet e faturimit duhet të jenë mjaft të sakta. Megjithatë, kjo mund të shtrembërohet nga banorët e Kosovës që emigrojnë duke lënë pas pronat e banuara më parë si të pa banuara. Ne presim që popullsia dhe analiza e kërkesës të marrin në konsideratë këtë dhe aspekte të tjera, por të mbështetura nga dëshmitë kur është e mundur, p.sh. parashikimet më të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës lidhur me migracionin neto.

Ne konsiderojmë se një pjesë e konsiderueshme e ujit të humbur nuk është domosdoshmërisht si pasojë e rrjedhjeve të ujit (humbje teknike), por i atribuohet ujit të pa faturuar (humbje komerciale). Kjo mund të jetë si pasojë e lidhjeve të pa regjistruara, matja e pasaktë nga ujëmatësit, administrimi i dobët i leximit nga personeli dhe arsye të tjera. Presim që planet e biznesit të ofrojnë prova të forta për të përcaktuar shkallen e humbjeve komerciale dhe aktivitetet që do të ndërmerren për të reduktuar këto humbje deri në minimum. Modeli ynë për përcaktimin e tarifave do të shtojë të hyra shtesë nga konsumi i tillë. Një plan i biznesit, i cili nuk ofron prova të besueshme mbi vlerësimin e humbjeve komerciale dhe nuk merr masa për përmirësimin e tyre nuk do të konsiderohet se plotëson kriterin e planit 'vlerësimi i shpejtë'. Pa evidencë të tilla ne do të bazohemi në shënimet e ofruara nga kompanitë tjera të cilat kanë plotësuar këtë kriter. Kur ne bëjmë vlerësimet tona ato do të shkojnë në favor të konsumatorëve do të thotë vlerësojmë më shumë humbje komerciale dhe më pak humbje teknike (për shkak të rrjedhjeve)

Vitet e fundit, KRU-të kanë përmirësuar performancën e tyre të mbledhjes së të ardhurave. Kur është e mundur, ne, ende presim që kjo ecuri të përmirësohet, por ne pranojmë se në një moment, kostot e nxitjes (sfidimit), mund të tejkalojnë të ardhurat shtesë. Ne presim që KRU-të të përpiqen të përmbushin këtë nivel maksimal të efektshmërisë me kalimin e kohës. Ne kërkojmë prova për të mbështetur aktivitetet e përmirësimit të mbledhjes së të ardhurave dhe, kur është e mundur, informacion lidhur me nivelin maksimal efikas të mbledhjes së të ardhurave.

Ne gjithashtu do të mirëpresim ndërmarrjen e iniciativave nga KRU për të përmirësuar efikasitetin në aktivitetet e tyre tregtare, p.sh. opsionet për pagesën elektronike të faturave.

Plani financiar

Politika jonë tarifore i konsideron strukturat e kapitalit të KRU-ve si një çështje menaxheriale dhe jo si një çështje rregullatore. Si pasojë, modeli ynë tarifor, nuk e konsideron borxhin dhe ekuitetin veç e veç, por e konsideron totalin e BRRRA-së. Ne jemi të vetëdijshëm se disa KRU kanë marrë përsipër detyrimet e borxhit me periodat e kthimit të parave, që janë më të shkurtra se jeta e aseteve që rezultojnë në streset e rrjedhjes së parave të gatshme. Ne kemi demonstruar në të kaluarën se zhvlerësimi i lejuar i kostos aktuale plus një kthim real mbi BRRRA që është më i madh se kostoja e borxhit, është më se i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e shërbimit të borxhit (interesi dhe principali). Nëse nuk na paraqiten prova për të kundërtën ky mbetet qëndrimi ynë. Nëse KRU-të konsiderojnë se nevojitet mbështetje financiare shtesë për të përmbushur çdo rrjedhje të mangët parash thekson se ajo do të duhet të mbështetet nga provat, p.sh. parashikimet e rrjedhës së parave. Parashikime të tilla do të marrin në konsideratë të gjitha përmirësimet e pritshme të efektshmërisë të përcaktuara në planet e tyre të menaxhimit të aseteve, operacionale dhe tregtare.

Objektivat për përmirësimin e nivelit të shërbimit

Nivelet e furnizimi me ujë dhe ujëra të zeza janë përmirësuar me kalimin e viteve, por janë ende nën atë që besojmë se duhet të jenë. Shqetësimi më i madh është niveli i vazhdueshëm i humbjeve të ujit që perceptohet të jetë shumë i lartë. Pavarësisht nga kërkesat tona të vazhdueshme që KRU-të të trajtojnë këtë, është bërë përparim shumë i vogël. Edhe detyra më themelore e përpjekjes për të përcaktuar se çfarë është humbje, për shkak të rrjedhjeve dhe çfarë është humbje komerciale nuk është trajtuar. Ne, e konsiderojmë çështjen e humbjeve komerciale, për t'u paraqitur në planet komerciale të KRUs dhe ne do të prisim që ato të përfshinin konsumatorët aktualisht të pafaturuar, për t'u shtuar në bazën e të dhënave të konsumatorëve.

Ne kemi një shqetësim se rrjedhjet aktuale në rrjete mund të jenë më të larta se niveli ekonomik i rrjedhjes, d.m.th. rrjedhjet po kushtojnë më shumë, se kostot për ta reduktuar atë. Ne presim që KRU-të të përfshijnë në

planet e biznesit tarifor 2026-2028 aktivitetet e nevojshme për **a)** të kuptojnë qartë pozicionin e tyre të rrjedhjes duke përfshirë një vlerësim të nivelit ekonomik të rrjedhjes, **b)** për të filluar masat për të reduktuar rrjedhjet në drejtim të përmbushjes së nivelit ekonomik të rrjedhjes. Për ta bërë këtë presim që aktivitetet e mëposhtme të përfshihen në planet e biznesit tarifor: menaxhimi i presionit për të reduktuar rrjedhjet kur është e mundur, krijimi i zonave matëse të qarqeve prej 500 deri në 5000 lidhje (në këtë kontekst një bllok apartamentesh konsiderohet si një lidhje e vetme), një vlerësim fillestar i rrjedhjes sipas zonës dhe fillimi i kontrollit aktiv të rrjedhjes për të përcaktuar me më shumë saktësi nivelin ekonomik të rrjedhjes. Me kalimin e kohës ne presim të vërejmë rrjedhjen që bie drejt nivelit ekonomik të rrjedhjes dhe bashkë me të edhe një reduktim të kostove nga ato aktuale. Deri sa këto masa të jenë në fuqi, ne nuk presim të shohim ndonjë reduktim material në rrjedhjen dhe kostot.

Ne, megjithatë, presim të shohim në planet tarifore të biznesit dispozita për punën përgatitore të nevojshme për masat e kontrollit të rrjedhjes kostot e të cilave duhet të shfaqen në kostot operacionale të planit të biznesit dhe të mbështetura nga provat. Këto kosto mund të përfshijnë edhe shërbimet e ekspertëve të jashtëm, që mund të emërohen, për të ndihmuar KRU-të me veprimtaritë e tyre të reduktimit të rrjedhjeve. Ne, gjithashtu, do t'i inkurajojmë KRU-të të konsiderojnë bashkimin e burimeve të tyre për të përmirësuar efikasitetin, p.sh. për dy ose më shumë KRU për të angazhuar një ekspert të vetëm për t'i ndihmuar ato.

Fusha të tjera për përmirësimin e shërbimeve përfshijnë, një faqe interneti funksionuese, për të ofruar informacion për konsumatorët (dhe për konsumatorët që të regjistrojnë ankesat nëse është e nevojshme), përmirësimin e shërbimeve të qendrës së thirrjeve telefonike dhe përmirësimin e kohës së reagimit për ankesat e konsumatorëve. Ne presim që, KRU-të të japin prova se do të përmirësojnë edhe më shumë shërbimet e klientëve në këto fusha.

Mjedisi

Përgjigjet ndaj konsultimit, përfshinin një kërkesë që rregullatori të shqyrtonte ndikimin mbi mjedisin. Ne e mbështesim këtë pozicion dhe do të shqyrtojmë veprimtaritë operacionale dhe të investimeve që janë projektuar për të përmbushur detyrimet e mbrojtjes së mjedisit. Edhe këto, do të duhet të mbështeten nga prova për të justifikuar domosdoshmërinë e tyre, rezultatet e pritshme, kostot e efektshme dhe sigurinë se ato do të realizohen.

Do të shqyrtojmë gjithashtu veprimtaritë operacionale dhe të investimeve që mund të përmirësohen për të mbrojtur më mirë mjedisin edhe nëse këto shtojnë kostot e përgjithshme. Kjo mund të përfshijë investimin në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme në mjediset e KRU, zëvendësimin e automjeteve me benzinë/naftë me automjete elektrike dhe më shumë. Për të mbështetur përfshirjen e veprimtarive të tilla dhe kostot e tyre, ne do të kërkonim prova lidhur me përfitimet e pritshme mjedisore (reduktimi i karbonit për shembull) së bashku me kostot realiste dhe garancitë se ato do të realizohen. Ne, nuk mund të garantojmë se të gjitha kostot do të pranohen në procesin e përcaktimit të tarifave pasi këto kosto do të duhet të balancohen kundrejt pasojave tarifore për konsumatorët. Në shumicën e rasteve ne presim që kostot të kenë një ndikim të kufizuar tarifor. Heqja e një veprimtarie operacionale apo investuese të projektuar për të mbështetur mjedisin me arsyetimin e të qenit në kundërshtim me interesin e konsumatorit nuk do të llogaritet domosdoshmërisht kundër përmbushjes së kualifikimit të "vlerësim i shpejtë".